

VENDIM
Nr. 8, datë 31.3.2014

PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS GRAMSH

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit të operatorit sh.a. Ujësjiellës Gramsh, me:
Drejtues ligjor: Tajar Bici
Drejtues teknik: Miranda Bici.
2. Operatori sh.a. Ujësjiellës Gramsh autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: bashkia Gramsh; komunat: Pishaj, Kodovjakë, Kushovë, Tunjë, Sult.
4. Kjo licencë është e vlershme për një periudhë 4-vjeçare deri më 30.3.2018.

KRYETARI
Avni Dervishi